



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë më, 01.11.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së Komisionit për projektligjin “Per Buxhetin 2019”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fate Velaj, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Alimra Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duak, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot në mbledhjen e Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik do të diskutojmë dy çështje, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 15 dhe 22 tetor, si dhe diskutimin dhe miratimin e kalendarit të punës së komisionit për muajin nëntor.

Fillimisht doja t'ju rikujtoja faktin që muaji nëntor i dedikohet buxhetit. Mbrëmë në mbledhjen e kryetarëve të komisioneve morëm një kalendar që ka miratuar Kuvendi për veprimtarinë e komisioneve, si dhe u njohëm me të gjithë procesin që do të kalojë projektbuxheti, i cili do të miratohet sot në seancë plenare, por e mira është që ne ta kemi parasysh se ky kalendar na e kushtëzon veprimtarinë.

E para, nisur nga puna që duhet të bëjmë për miratimin e kalendarit dhe për kordinimin e prezencën të antarëve në komisionin, duhet të kemi parasysh se kuorumi duhet realizuar patjetër në cdo mbledhje nga ne antarët e këtij komisioni, ndaj ju kërkoj që të paktën deri më datë 21 apo 22 të kemi një angazhim total për të qenë të pranishëm në mbledhje dhe ai që largohet, duhet të lajmërojë më përpara, që të gjejmë zëvendësuesin, gjithmonë nëse lëvizni jashtë vendit. Mos harroni që është pak e vështirë, sepse çdo komision ka mbledhjet e veta, prandaj duhet të rregullojmë më parë oraret me këto komisione.

E dyta, së bashku me sekretarinë e komisionit është përgatitur një kalendar, i cili ndjek këtë logjikë. E para, diskutimi dhe miratimi në parim i projektbuxhetit dhe, më pas, diskutimi nën për nen, duke thirrur shoqata, të interesuar, grupe interesi, ashtu siç e bëmë edhe vjet.

Ndoshta dëgjuesat mund të na marrin shumë orë, sepse duhet t'i marrim grupet njëri pas tjetrit për t'i kaluar si proces. Kam hartuar një kalendar-draft, duke pasur parasysh që gjatë kësaj periudhe kemi edhe dy angazhime të tjera. I pari është angazhimi i dëgjësës për fillimin e vitit të ri akademik, të cilin e kemi planifikuar që më parë dhe për këtë do të thërrasim ministren e Arsimit, zonjën Nikolla, ndërsa angazhimi tjetër lidhet me kërkesën bërë OSBE për vizitat në Gjirokastër dhe Butrint. Pra, duke pasur parasysh këto dy gjëra, është bërë edhe kalendar.

Gjithashtu, Ariana, Muhameti dhe Gazi kanë punuar me procesverbalet e radhës së kaluar, për të konsultuar listën e të ftuarve që kemi pasur. Përveç kësaj, kemi vënë re me kujdes se çfarë kërkesash kanë ardhur në komision nga grupet e tjera që kanë dorëzuar letrat, të cilët janë të rinj që janë shtuar në këto dëgjesa. Pra, këto janë tri grupet kryesore të takimeve: diskutimi në parim

që janë ministritë e linjës, diskutimi i nën për nën që janë grupet e interesuara që kanë qenë vjet dhe ato që janë shfaqur këtë vit, dëgjesa me ministren e Arsimit dhe vizita në Gjirokastrë dhe Butrint.

Ju keni përpara një draft kalendar pa data, ku janë përcaktuar qëllimet kryesore. Unë do t'ju propozoj që sot, pasi kalendarin të miratohet në Kuvend, t'ju vijë të gjithëve në *e-mail* një kalendar me data të përcaktuar për të njoftuar palët

Ti, Fate, kur nuk do të jesh në Shqipëri?

Fatmir Velaj – Unë nuk do të jem nga datat 17-18 nëntor.

(Diskutime pa mikrofon.)

Jo, më fal, i bie data 19-20 nëntor.

Milva Ekonomi – Pra, duke pasur parasysh këtë gjë, do të shohim se si janë komisionet e tjera. Do t'i kërkojmë ndihmë zëvendësuesve të jenë në komision. Pra duke pasur parasysh mungesat, duhet të shohim kuorumin dhe në bazë të tij duhet të bëjmë edhe kalendarin definitiv të veprimtarisë së komisionit.

A biem dakord?

Këto tri javë duhet një angazhim total, se nuk ia dalim dot.

(Diskutime pa mikrofon.)

A mund ta votojmë në parim këtë lloj veprimtarie të komisionit? Jeni dakord?

Dakord.

A i lexuat procesverbalet? Ata që kanë komente i kanë dërguar tek Ariana?

Jeni dakord me procesverbalet? Dakord.

Musa Ulqini – Doja të thosha diçka, sa u takon seancave dëgjimore, plotësimi i dy kushteve, të cilat duhet t'i themi paraprakisht. Pra, këta persona e kanë kohën e limituar dhe e dyta duhet t'i sjellin materialet e tyre me shkrim. Pse me shkrim? Duhet t'i sjellin me shkrim që të mos thonë se nuk arritën të shpreheshin. Këto janë dy gjërat kryesore kur bëhen njoftimet, që ata të mos vijnë për të bërë shou, e kam fjalën për një pjesë të këtyre grupeve që lidhen me interesat e shoqërisë civile, të cilët vijnë, regjistrohen në komision dhe thonë: thamë këto gjëra e të tjera. Unë mendoj që propozimet e tyre duhet të jenë edhe me shkrim, dhe në këtë mënyrë procedohet edhe më shpejt, pasi kemi shumë dëgjesa.

Fadil Nasufi – Kisha edhe unë diçka për procedurë.

Së pari, ne duhet t'u krijojmë prioritet institucioneve që financon buxheti i shtetit.

Së dyti, ne jemi komision për dhënie mendimi, nuk jemi vendimmarrës, duhet t'i paraprijmë Komisionit të Ekonomisë dhe Komisionit të Ligjeve, prandaj duhet të ecim më shpejt, që këto komisione të kenë kohën e vendimmarrjes. Gjithashtu, duhet të punojmë paradite dhe pasdite. E di që humbasim gjithë ditën, pasi kemi edhe angazhime publike nëpër zonat që ne përfaqësojmë, por buxheti është shumë i rëndësishëm.

Pra, duhet të kemi një gjetje dhe një maksimalizim të kohës në dispozicion për këto diskutime. Çdo gjë duhet të jetë e shkruar, kemi këto propozime dhe këto kërkesa, projektbuxheti nuk i ka parashikuar, kërkojmë rritje këtu apo aty e kështu me radhë.

Milva Ekonomi – Muhamet, dëshiron të thuash ndonjë gjë?

Muhamet Bela – Unë doja të thosha se institucionet qendrore gjatë gjithë praktikës së diskutimit të projektbuxhetit janë ftuar në diskutimet në parim, si Akademia e Shkencave, Akademia e Studimeve Albanologjike, QKK-ja, pra këto janë institucione që varen nga komisioni ynë, ndërsa sindikatat dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile janë thirrur, kur është bërë diskutimi nen për nen.

Dihet që raporti dorëzohet dy ditë para në Komisionin e Ekonomisë, prandaj kjo gjë duhet të planifikohet. Në qoftë se duhet të dorëzohet me datë 16, atëherë me datë 13 duhet të ketë mbaruar diskutimi në parim dhe raporti i Komisionit.

Milva Ekonomi – Këtë logjikë kemi ndjekur edhe kemi bërë propozimet për draft - kalendarin.

Ismet Beqiraj – Kisha diçka për procedurë. Në mbështetje të asaj që kërkuan Musai dhe Fadili, propozimet vijnë me shkrim dhe po me shkrim të njihen edhe deputetët, që ne të mos fillojmë të shfletojmë në momentin që ata flasin dhe bëjnë rekomandimet e tyre, prandaj paraprakisht duhet të jemi të përgatitur për ato që ata kërkojnë. Në të kundërt, do t'ju sugjeroja se kush nuk është korrekt me këtë kërkesë që paraprakisht edhe deputetët të njihen me kërkesat e tyre, nuk kemi pse t'i thërrasim në dëgjese.

Milva Ekonomi – Ke shumë të drejtë.

Ismet Beqiraj – Jo, kjo duhet të jetë formalisht, sepse mua më duhet të sforcohem dhe të shoh se çfarë është në projektbuxhetin që ka miratuar qeveria dhe çfarë kërkojnë këta.

Milva Ekonomi – I gjithë dokumentacioni do t'ju vijë me *e-mail*. Pra, duke ju ardhur i gjithë informacioni me *e-mail*, përpikuni të bëni dy gjëra: hapni adresën *parlament.al*, sepse të

gjithë kemi adresë funksionale dhe nuk është e gjithë përgjegjësia e Arianës, i dërgoi apo nuk i dërgoi, pasi të gjitha dokumentet janë në platformë dhe në këtë mënyrë i gjen gjithsecili, dhe i shkarkon vetë.

E dyta, sekretaria asnjëherë nuk ka vonuar asnjë shkresë që ka ardhur për dëgjuesë, sepse çdo shkresë ka ardhur në momentin kur e kanë sjellë ata. Ajo që Ismeti kërkon është që atyre t'u bëhet me dije që duhet ta sjellin 48 orë përpara...

Pra, ju lutem, përpikuni ta hapni adresën *parlament.al* dhe atje i keni të gjitha dokumentet!

E dyta, t'u kërkojmë të ftuarve që të na i sjellin jo më vonë se 24 ore përpara mendimet e tyre me shkrim.

Adelina Rista – Unë e mbështes Fadilin që për të kapur kohën, seancat t'i bëjmë në mëngjes dhe pasdite.

Milva Ekonomi – Patjetër!

Fidel Ylli – Do të bëjmë një pushim në drekë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Jemi dakord me kalendarin? Po.

Unë do të flas me zëvendësuesit dhe i gjithë procesi do të mbarojë deri në fund të ditës së sotme.

(Diskutime pa mikrofon.)

Duhet lajmëruar Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Akademia etj., të dërgojnë materialet, sepse javën që vjen fillojnë dëgjesat për buxhetin.

MBYLLET MBLEDHJA